



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01- 0005630-16/26, dt. 10.02.2026

Mitrovicë

02-060/01-0005630-16/26

10.02.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 25, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike, nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, neni 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P. "Stacioni i Autobusëve" - SH.A.

- Me këtë vendim FORMOHET Komisioni Komunal të Aksionarëve të N.P. "Stacioni i Autobusëve" - SH.A., në përbërje:
 - Artan Berisha,
 - Erseka Barani, dhe
 - Mujë Igrishta (I cmëruar nga Kryetari i Komunës).
- Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.
- Komisioni me shumicë të thjeshtë votash vendos se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.
- Komisioni do të përgatisë dhe nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen e N.P. "Stacioni i Autobusëve"- SH.A. Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.
- Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj dhe do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.
- Komisioni i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj.
- Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL-së
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Anëtarëve të Komisionit



Safet KAMBERI